



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 12 dhjetor 2013
Nr.ref.:RK514/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI98/13

Parashtrues i kërkesës

Muharrem Alija

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 121/2010, të 19 shkurtit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Muharrem Alija, me vendbanim në Pejë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 121/2010, i 19 shkurtit 2013, dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 11 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 121/2010, i 19 shkurtit 2013), me të cilin ishin vërtetuar aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe të Gjykatës së Qarkut në Pejë.
4. Me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë ishte refuzuar padia e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë për vërtetimin e pronësisë së paluajtshmërisë së paraardhësit të tyre, apo kompensimit me një pronë tjetër apo kompensimit në të holla.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 gusht 2013, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR.KI 98/13 e caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin KSH.KI 98/13 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 27 gusht 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe i kërkoi parashtruesit të dorëzojë fletëkthesën, që tregon datën se kur ai e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 121/2010, të 19 shkurtit 2013. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme lidhur me regjistrimin e kërkesës.
9. Më 29 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 121/2010, i 19 shkurtit 2013, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 11 mars 2013.
10. Më 19 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës, së bashku me vëllanë e tij, D. A., dhe mbesën XH. K., në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit M. A. kundër Kompanisë së ujit të pijes “Hidrosistemi Radoniq” dhe Kompanisë së ujitjes “Radoniq-Dukagjin” në Gjakovë, kishin paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, me kërkesën që të vërtetohet se janë bashkëpronarë me madhësi të barabarta të paluajtshmërisë së regjistruar si parcelë me nr. 933 në sipërfaqe prej 0.92.00 ha dhe parcelës me nr. 933/2 me sipërfaqe prej 0.14.68 ha.
12. Sipas parashtruesit të kërkesës, paluajtshmëria e lartcekur kishte qenë pronë e babait të tij, i cili të njëjtën e kishte shfrytëzuar derisa ishte në jetë, duke pohuar më tej se edhe pasardhësit e tij kishin vazhduar shfrytëzimin e së njëjtës paluajtshmëri deri në kohën kur e njëjta ishte përmbytur nga liqeni i Radoniqit.
13. Në padi ishte saktësuar më tej që Kompania e ujit të pijes “Hidrosistemi Radoniq” dhe Kompania e ujitjes “Radoniq-Dukagjin” në Gjakovë [...] *“detyrohen që ta pranojnë dhe për këto pjesë të parcelave të cekura t’ua dorëzojnë në pronësi paditësve si zëvendësim dhe kompensim paluajtshmërinë tjetër adekuate, ose t’ua paguajnë shumën prej 33.952,00 €, në emër të kundërvlerës të pjesëve të parcelave të cekura [...]”*
14. Në bazë të Historiatit të Shërbimit për Kadastër dhe Patundshmëri në Gjakovë (Nr. 01-952-2-58, të 16 shkurtit 1995) pas ndryshimit të gjendjes së paluajtshmërisë në bazë të vendimeve administrative nga viti 1933 (viti kur paluajtshmëria ishte evidentuar në emër të babait të parashtruesit) e tutje, parcelat nr. 933 dhe 933/2, në bazë të vendimeve për shpronësim të Sekretariatit të Komunës së Gjakovës të 18 dhjetorit 1978 dhe 7 marsit 1978, për nevojat e ndërtimit të Hidrosistemit “Radoniq” kishin kaluar në pronë shoqërore të Ndërmarrjes Shoqërore, organizatës ekonomike të ujërave “Metohija”, paraardhëse e Ndërmarrjes Shoqërore “Hidrosistemi Radoniq” në Gjakovë. Në vitin 1993, parcelat nr. 933 dhe nr. 933/2 bashkohen në fletën poseduese nr. 1, në emër të Ndërmarrjes Shoqërore “Hidrosistemi Radoniq”.
15. Më 26 maj 2008, Gjykata Komunale në Gjakovë përmes Aktgjykimit (C. nr. 495/05), ka refuzuar në tërësi si të pathemeltë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
16. Gjykata Komunale në Gjakovë në Aktgjykimin e saj (C. nr. 495/05, të 26 majit 2008) arsyetoi se paraardhësja juridike e së paditurës së parë, përkatësisht Ndërmarrjes Shoqërore të ujit të pijes “Hidrosistemi Radoniq” në Gjakovë, paluajtshmërinë lëndore e ka fituar në bazë [...] *“të punës së vlefshme juridike dhe atë në mënyrë origjinale ndaj KK Gjakovë. Këtë qëndrim e bën edhe më të besuar fakti se sipas nenit 3 parag. 1 të Ligjit mbi regjistrimin e pasurive të patundshme në pronësinë shoqërore (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës nr. 37/71), i cili ligj është aplikuar edhe sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, parashihet se regjistrimi i pasurisë së patundshme në pronësinë shoqërore bëhet në bazë të një vendimi në formë të prerë të gjykatës ose*

organit tjetër kompetent (në rastin konkret të organit administrativ) me të cilin konstatohet se pasuria e patundshme ka kaluar në pronësi shoqërore. [...] në rastin konkret meriton të potencohet edhe fakti se paluajtshmëria lëndore para se të fundosej me ujin e Hidrosistemit të paraardhësit juridik të së paditurës së parë ka qenë pronësi shoqërore e Bashkësisë Lokale Gërgoc dhe rrugë publike jo e kategorizuar, të cilat janë kategori e veçantë e pronësisë në të cilën personat fizikë në asnjë mënyrë nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë, sepse janë në shfrytëzim dhe përdorim publik”.

17. Gjykata Komunale po ashtu kishte konsideruar se parashtruesi dhe paditësit nuk kishin dëshmuar se i kishin përmbushur detyrimet e tyre, përkatësisht pagesën e tatimeve të rregullta vjetore, dhe deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nuk kishin arritur t'i vërtetojnë Gjykatës se e kishin trashëguar paluajtshmërinë lëndore nga paraardhësi i tyre juridik.
18. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë (C. nr. 495/05, të 26 majit 2008), parashtruesi i kërkesës, D. A. dhe XH. K. ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
19. Më 10 dhjetor 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin (Ac. nr. 223/09), me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe paditësve të tjerë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë (C. nr. 495/05, të 26 majit 2008).
20. Gjykata e Qarkut në Pejë konstatoi se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt gjendjen faktike, duke konstatuar se në vitin 1978, paluajtshmëria ka kaluar në pronë shoqërore në bazë të vendimit të formës së prerë të organit kompetent, si dhe përfundoi se në mënyrë të drejtë është zbatuar e drejta materiale.
21. Gjykata e Qarkut në Pejë, po ashtu konstatoi se padia për rikthimin e pasurisë për herë të parë nga paditësit ishte ushtruar në vitin 1996, respektivisht 18 vjet që nga koha kur paluajtshmëria ka kaluar në pronësi shoqërore dhe ka qenë në posedim të pandërprerë nga ana e personave juridikë, duke vlerësuar se [...] *“paraardhësit të paditësve dhe paditësve u ka pushuar e drejta e pronësisë në bazë të nenit 45 të Ligjit mbi bazat e marrëdhënieve juridike – pronësore. Kjo për faktin se në bazë të nenit 226 (228) të Ligjit mbi punën e bashkuar, saktësisht parashihet se, nëse patundshmëria është bërë mjet shoqëror, e në rastin konkret pronë shoqërore pa bazë juridike, kthimi i së njëjtës mund të kërkohet në afat prej 5 vjetësh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej 10 vjetësh”.*
22. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (Ac. nr. 223/09, të 10 dhjetorit 2009), parashtruesi i kërkesës dhe paditësit e tjerë me pohimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, paraqitën revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
23. Më 19 shkurt 2013, Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit (Rev. nr. 121/2010), revizionin e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (Ac. nr. 223/2009, të 10 dhjetorit 2009) e refuzoi si të pabazuar.

24. Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se [...]“gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, se aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, se gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë”.
25. Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e saj më tej konstatoi se [...]“gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë vlerësuar se e paditura e parë pronësinë e ka fituar në mënyrë origjinare në bazë të vendimit të formës së prerë të organit kompetent, e në rastin konkret të organit administrativ”.

Pretendimet e parashtruesit

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 121/2010, i 19 shkurtit 2013) shkel të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
27. Lidhur me pretendimin e tij për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës, parashtruesi pohon se e drejta e tij e garantuar me Kushtetutë është mohuar për arsye se pronar i patundshmërisë kontestuese ishte paraardhësi i tij dhe se ai dhe paditësit e tjerë ishin trashëgimtarë të tij ligjorë.
28. Lidhur me pretendimin e tij për shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtruesi pretendon se parimi i barazisë para ligjit nuk është respektuar për arsye se në rastin konkret përparësi i është dhënë [...]“organizatave shoqërore të ish-Jugosllavisë në raport me kërkesat e personit fizik”.
29. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që: “Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 121/2010, i 19 shkurtit 2013, të shpallet jokushtetues dhe si i tillë të priset me sugjerim që të aprovohet kërkesa e paditësve për kompensim, qoftë me një pronë tjetër të ngjashme, qoftë në të holla”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”*.
33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës për të mbrojtur të drejtat e tij i është drejtuar Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë, dhe në fund Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 11 mars 2013 dhe ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 10 korrik 2013.
34. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit katërmuajsh.
35. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar”*.
- “(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- [...], ose*
- b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; ose*
- [...], ose*
- d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.
36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 121/2010, i 19 shkurtit 2013) me të cilin janë vërtetuar aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Gjakovë (C. nr. 495/2005, të 26 majit 2008) dhe të Gjykatës së Qarkut në Pejë (Ac. nr. 223/2009, të 10 dhjetorit 2009) shkel të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, duke pohuar se aktgjykimet e lartcekura e [...] *”e shpërfillin të drejtën në pronë si të drejtë themelore dhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut, ashtu edhe faktin se lidhur me shpronësim nuk kishte kurrfarë procedure”*.
37. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
38. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e

tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rasti Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

39. Në bazë të shkresave të rastit, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë me aktgjykimin e fundit nga Gjykata Supreme është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
40. Për më tepër, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konfirmoi se “*gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë vlerësuar se e paditura e parë pronësinë e ka fituar në mënyrë origjinare në bazë të vendimit të formës së prerë të organit kompetent[...]*”.
41. Nga arsytet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullat 36 (2), b) dhe d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T’UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani